

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**Blerje beton i gatshëm**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

44114100-3 Beton me përzierje të gatshëm

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**3,339,180** (tre milionë e treqind e tridhjetë e nëntë mijë e njëqind e tetëdhjetë ) **Lekë, pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. . Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

1. Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë **ISO 9001-2015 ose ekuivalent** (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së .

2. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë **ISO 14001-2015 ose ekuivalent** (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të mjedisit. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo certifikatë ofron një kuadër praktik për shoqëritë që menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Është pranuar në mbarë botën se burimet e botës sonë, që po pakësohen nga dita në ditë, nuk janë të pafundme dhe se ndikimet mjedisore të produkteve dhe aktiviteteve nuk janë lokale dhe rajonale por globale. Ky ndërgjegjësim ka sjellë nevojën për të kontrolluar ndikimet mjedisore. Të qenit i pranishëm në tregun lokal dhe atë global, tani po matet me respekt dhe respekt që u jepet njerëzve. Përveç përmbushjes së pritshmërive dhe nevojave të konsumatorëve të sotëm në nivelin më të lartë, kërkohet që të vlerësohet dhe respektohet mjedisi dhe bota në të cilën jetojmë.

Këto zhvillime kanë zbuluar faktin se ekziston një nevojë për sisteme menaxheriale që do t'u mundësojnë bizneseve të mbajnë nën kontroll ndërveprimet e tyre me mjedisin dhe të përmirësojnë vazhdimisht aktivitetet dhe arritjet e tyre mjedisore. ISO 14000 është një standard i sistemit, i cili bazohet në monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të performancës mjedisore. Ajo është në përputhje me kushtet e përcaktuara nga legjislati përkatës dhe ligjet në lidhje me faktorët e mjedisit. Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit quhet Sistemi i menaxhimit që çdo kompani zhvillon për reduktimin sistematik dhe eliminimin e mundshëm të dëmeve që ato mund të shkaktojnë në mjedis. Pra, si rezultat i këtij gjykimi menaxhimi i mjedisit që ka lidhje me certifikatën ISO 14001:2015 është standart me të cilin **duhet të operojë çdo kompani pavarësisht fushës së saj të aktivitetit apo madhësisë së saj**. Ky standart tregon se kompania gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj operon në përputhje me parimet e mbrojtjes së ekosistemit dhe minimizimin e efekteve negative në mjedis.

## 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022,2023,2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20 % e vlerës së fondit limit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Autoriteti Kontraktor i është referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43, pika 2, gërma c) pasi fondi limit i procedurës së prokurimit ndodhet nën kufirin e ulët monetar.

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

*(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklarave vjetore pranë organeve tatimore).*

## 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi,

dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.*

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë raportin e testimit dhe raportin e analizave, të lëshuar nga një laborator i çertifikuar nga organet kompetente të Shtetit Shqiptar, për mallin objekt prokurimi.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 6/c e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për rezultatet zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

3. Operatori ekonomik duhet të disponoj impiant prodhim betoni në pronësi/me qera ose menyra të tjera të disponimit të parashikuara në legjislacionin në fuqi, ose kontratë furnizimi për mallin objekt prokurimi, të lidhur para noterit, me afat deri në përfundimin e kontratës. Për impiantin duhet të paraqitet Leje Mjedisore tipi B (Kodi III.1.B) në përputhje me objektin e prokurimit, të vlefshme deri në realizimin e kontratës.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; në zbatim të ligjit 10431, datë 9.6.2011 “Për

mbrojtjen e mjedisit”, ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë kapacitete teknike me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses si dhe të dëshmojnë se e ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me kërkesat, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat e legjislacionit mjedisor me qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nga administratori ku merr përsipër në çdo kohë furnizimin e Autoritetit Kontraktor në të gjithë ditët e javës, në vendin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikës 8 të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë disponueshmërinë e tyre për dërgimin e mallit në vendet e përcaktuara nga AK sipas kërkesave të tij në funksion të mbarëvajtjes së proceseve të punës.

5. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

| Nr. | Mjetet           | Sasia  | Gjendja             |
|-----|------------------|--------|---------------------|
| 1   | Autobetoniere    | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| 2   | Autopompë betoni | 2 copë | Pronësi ose me qera |

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit; a) leje qarkullimi; b) certifikatën e kontrollit teknik; c) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm).
- b) Për mjetet e marra me qira duhet të paraqitet: a) leje qarkullimi; b) certifikatën e kontrollit teknik; c) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); Mjetet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qirasë, lidhur para noterit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi.
- c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se OE kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Mjetet e mësipërme janë të domosdoshme pasi duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet teknike të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses sipas nevojave që ka AK. Për vetë llojin e mallit objekt prokurimi, transportimi i tij nga vendi i prodhimit deri në kantieret e kërkuara realizohet me mjete të veçanta siç janë autobetonieret. Ndërsa aplikimi dhe hedhja e tij në kantier realizohet nëpërmjet autopompave të betonit. Numri minimal i kërkuar i mjeteve është caktuar duke marrë në konsideratë volumin dhe nevojën për beton në kantiere të ndryshme në të njëjtën kohë.

*Shënim: Autoretit /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:*

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike të mallit objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për Beton C - 20/25 (me çakëll) që ka AK, i cili shërben për realizimin e proceseve të punës, konkretisht ndërtimi i shtresave kaluese rrugore prej betoni dhe beton arme në rrugët rurale, për ndërtimin e mureve mbajtëse dhe pritëse, për veshjen e kanaleve vaditëse dhe kulluese si dhe për ndërtimin e mureve të vogla në funksion të mirëmbajtjes së trotuarëve etj, ndërtim kunete. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

*Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 6 të Dokumentave Standarte të Tenderit.*

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

## **NJËSIA E PROKURIMIT**